



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

NENTOR, 2024

Buletini Muja i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin nentor 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit nentor 2024 zënë 29.2 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 214.4/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 2.1/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin nentor 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin nentor 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste nentor 2024	Incidenca nentor 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.03
Salmoneloza	5	0.17
Shigelozë (Disenteri bacilare)	2	0.07
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	61	2.1
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6069	212.0
Sëmundje diarreike në total	6138	214.4

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit nentor 2024 janë raportuar në total 183 raste variçelë (incidenca 6.3/ 100.000 banorë) nga të cilat, 100 raste janë të dyshuara dhe 83 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 75 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 93 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, nentor 2024



2.2 Fruthi

Gjate muajit nëntor nuk është raportuar asnjë rast me fruth.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024




3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin Nëntor janë raportuar 6 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në muajin Korrik është 0.2 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve




Rastet në muajin Nëntor i përkasin grupmoshës adulte nga 36-62 vjec, 4 raste (66%) të gjinisë mashkull dhe 2 femër (34%), janë banorë nga bashkia Durrës (4), Lushnje (1) dhe Elbasan (1), dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin Nëntor është raportuar tre raste të konfirmuar me HCV. Rastet i përkasin bashkisë Dibër (1), Gjirokastrë (1) dhe Elbasan (1), të moshës i moshës 65-74 vjec, gjinia mashkull, dhe kanë shfaqur shenja klinike të HCV.


Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HCV dhe incidenca (raste/100 000 banore) sipas muajve



4. Sëmundje seksuale të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit Nëntor 2024 janë kryer 30 **ekzaminime** për HIV (22 meshkuj dhe 8 femra) prej të cilëve 11 raste (8 meshkuj dhe 3 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv (Grafiku 5).

Grafiku 5. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin Nëntor 2024.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është : Tiranë **8 raste** (nga te cilet 2 raste janë me shtetësi të huaj), Durrës **2 raste** dhe **1 rast** Rreshen. (Grafiku 6)

Grafiku 6. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara në muajin Nentor 2024



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: **2 raste** i përkasin grup-moshës 0-4 vjec, **5 raste** i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç dhe **4 raste** i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur **5 raste** nga QSUT (**4 raste** nga Shërbimi Infektiv dhe **1 rast** nga Pediatria Infektive që është në ndjekje për konfirmim diagnoze), **3 raste** vijnë nga laboratorë private (**1 rast** – INTERMEDICA, **2 raste** – GENIUS), dhe **3 raste** janë referuar si donatorë gjaku nga QKTGJ.

Gjatë muajit nentor 2024 janë raportuar 8 raste të konfirmuar Sifiliz, 5 raste nga Tirana dhe 1 rast nga Durrësi, 1 nga Mirdita dhe 1 nga Korca.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit Nëntor 2024 janë raportuar gjithësej 18 raste me tuberkuloz (TB). Prej të cilave 16 raste janë pulmonar dhe 2 raste ekstrapulmonare. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 6 në Tiranë, 2 në Dibër, 1 në Lezhë, 3 në Shkodër, 1 në Elbasan, 2 në Gjirokastrë dhe 1 në Bulqizë. Ekstrapulmonare përkatësisht janë 2 raste: 1 në Elbasan dhe 1 në Laç.

Raste recidive per muajin Nentor ka vetëm 1, në Lezhë.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin nentor 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Nentor (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	1	0.03

Për muajin nentor janë raportuar 4 raste Bruceloze përkatësisht: 1 në Shkodër, 2 në Kolonjë dhe 1 në Berat. Gjithashtu është raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Berati.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

Gjatë muajit nëntor 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 3 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin nëntor është 0.1 raste /100000 banorë. Asnjë rast nuk ka qenë i shtruar në spital

7.2 Grip

Gjatë muajit nentor janë testuar 328 mostra për grip, dhe vetëm 1(0.03%) ka rezultuar pozitive me Grip Tipi A.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Malarie

Për muajin korrik është raportuar 1 rast i konfirmuar në Laboratorin e Kontrollit të Vektorëve në ISHP me Malarie Plasmodium Vivax. Rasti është i moshës 40 vjeç, gjinia mashkull, ardhur nga Afganistani.

8.2 Leshmanioza Viscerale

Për muajin nentor 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale nga Dibra.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI